

ZBULO!

Kurrikulumi Veror

Produkt i Balkan Sunflowers Kosova

Written and Compiled By: Joanna Laursen Brucker

Përkthyer nga:

Fjolla Dumani dhe Elird Haxhiu, Shqip
Jovana Skrijel dhe Jelena Poucki, Serbisht

Formatimi dhe Dizajni:

Kushtrim Visoka

Vizatimet:

Loren Bondurant

<http://www.balkansunflowers.org>
<http://www.learningcentersnetwork.org>

Të dashur Staf, Donatorë dhe Lexues,

Unë ju ftoj të na bashkangjiteni në aventurën tonë verore përmes Planprogramit ZBULO! Planprogrami i sivjetshëm i programit veror të BSFK-së i shpien studentët dhe stafin në një zbulim nën udhërrëfimin e A dhe L. Këto dy personazhe imagjinare do t'i udhëheqin fëmijët nëpër gjashtë tema javore.

- **Rreth Botës** eksploron ushqimin, kulturën dhe artin e Brazilit, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Indisë, Kenisë dhe Italisë.
- **Ndezja** udhëton me një astronaut që nga nisja e deri tek aterimi i aeroplanit dhe në mes ka një ecje në hënë.
- **Trupi i Njeriut** na merr brenda për të parë destinacione të mrekullueshme: trurin, mushkëritë, zemrën dhe sistemin e tretjes.
- **Hetimi i Kinkakujit** është një misterie krimi që përpiket të zbulojë kush e ka vjedhur Tempullin e Pavillionit të Artë në Japoni.
- **Pylli** kërkon thellë në Pyllin e Amaznit duke i vizituar tri shtresat e pyllit dhe duke u njoftuar me njerëzit që jetojnë atje.
- **Nën Det**, duke shetituar me nëndetësen tonë, eksploron thellësinë e detit dhe gjallesat e saj.

Rrugës, fëmijët do të ushtrojnë gjuhën, aftësitë matematikore dhe artistike, në mënyrë që ne të sigurohemi që ata e ushtrojnë trurin gjatë tërë verës.

Planprogrami në vetvete është një kombinim i aktivitetëve të krijuara ose të inspiruara nga diku tjetër. Citimet në këto raste janë të dhëna për çdo aktivitet. Planprogrami do të ishte i pamundur pa ndihmën dhe mbështetjen e shumë pjesëtarëve të komunitetit të Balkan Sunflowers. Secili student në të katër qendrat ka qenë i inspirim për këtë vepër; shpresoj që ata të mësojnë mirë.

Do të doja t'i falënderoja në veçanti përkthyesit e këtij planprogrami: Fjolla Dumanin dhe Endrit Haxhiun për përkthimin në shqip, Jovana Skrijel dhe Jelena Poucki për serbisht. Poashtu dua ta falënderoj Yllëza Berishën, Milica Milovic, Nenad Andric, dhe Driton Berishën për redaktimin gjuhësor. Gjithashtu dua ta falënderoj Muhamet Arifin dhe Rand Engel për idetë e tyre kreative, si dhe Kushtrim Visokën i cili e ka bërë dizajnin dhe formatin final të planprogramit. Falënderimi shkon edhe për Loren Bondurant, aftësitë artistike të së cilës i kanë vënë në jetë A-në dhe L-në. Dhe në fund, njësitë me tema nga vendet e ndryshme do të ishin të pamundura pa ekspertizën e George Symonds dhe Martina Akinyi. Falënderit për kontributin tuaj për Keninë dhe Japoninë, respektivisht.

Dhe tani, ju ftoj t'i bashkangjiteni A-së dhe L-së në një verë përplot dëfrim dhe aventurë.

Joanna Laursen Brucker



Zbulo

A & L Hyrja

Unit 1

Rreth Botës

Unit 2

Ndezja

Unit 3

Trupi i Njeriut

Unit 4

Hetimi i Kinkakujit

Unit 5

Pylli

Unit 6

Nën det



rreth botes

Rreth Botës. A&L kanë shkuar në një aventurë rreth botës. Çdo ditë të javës së ardhshme, ata do të vizitojnë një vend duke eksploruar gjuhën, kulturën, vallëzimin dhe ushqimin me ndihmën e një miku nga secili vend.

E hënë: Brazili

Qendrat Matematikore dhe Gjuhësore për këtë ditë mund të bëhen si mini-stacione, por Qendra e Artit/Tema Qendrore duhen të bëhen si projekte individuale sepse ky aktivitet bazohet në atë që është mësuar në Qendrën Matematikore dhe Gjuhësore.

- Hapja në rreth. 10 min
Rrotullo botën. Gjatë aktiviteteve të Hapjes në Rreth dhe energizorëve për këtë javë, ju lutem tregojuni fëmijëve me hartë se ku ne po udhëtojmë me A&L dhe pak për historinë e vendit, lokacionin e tij etj. Disa fakte për t'i përfshirë sot mund të jenë:
 - Brazili është vendi më i madh në Amerikën Jugore
 - Brazil është vendi i pestë më i madh në botë
 - Popullsia është mbi 190 milion njerëz
 - Vendësit flasin Portugalisht
 - Vendi është shtëpia e shumicës së Pyllit Amazon
 - Vendi ka ndoshta ekipin më të mirë në futboll
 - Karnavali është festa më e madhe në Brazil

Tani ne jemi jashtë për të eksploruar vendin me ndihmën e João.
- Qendra Gjuhësore: PS-BOTA-01 25 min
Le të takojmë João-n
- Qendra Matematikore: PS-BOTA-02 25 min
Format
- Tema Qendrore: PS-BOTA-03 25 min
Emocionet dhe krijimi i maskave
- Qendra e Artit: PS-BOTA-03 25 min
Emocione dhe krijimi i maskave
- Mbyllja në rreth 10 min

E martë: SH-B-A

Sot, Qendra e Artit duhet të jetë pas Temës Qendrore

- Hapja në rreth 10 min
Billy mirëpret A&L në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Disa fakte për të ndarë me fëmijët rreth Amerikës mund të jenë:
 - Shtetet e Bashkuara janë të vendosura në Amerikën e

Veriut

- Ai është vendi i tretë më i madh për nga sipërfaqja e tokës dhe popullsia
- Popullata është mbi 308 milionë njerëz
- SHBA ka ekonominë më të madhe në botë
- Kryeqyteti është Washington, D.C.
- Gjuha kombëtare është gjuha Angleze

Billy është nga Nju Meksiko që gjendet në pjesën jugperëndimore të Shteteve të Bashkuara. Nju Meksiko është qytet shumë i larmishëm me emigrantë nga Meksika dhe Amerika Latine dhe gjithashtu ka shumë amerikanë amtar.

• Qendra Gjuhësore SH-B-A	PS-BOTA-04	25 min
• Qendra Matematikore 13 shtetet	PS-BOTA-05	25 min
• Tema Qendrore Dielli dhe Hëna	PS-BOTA-06	25 min
• Qendra e Artit Bëni diellin dhe hënën	PS-BOTA-07	25 min
• Mbyllja në rreth		10 min

E mërkurë: Indi

• Hapja në rreth Satya na mirëpret në Indi.		10 min
○ Vendi i 7-të më i madh në botë për nga hapësira gjeografike		
○ I 2-ti më i populluar: 1.2 miliardë njerëz		
○ India është një gadishull i rrethuar me ujë në tre anët dhe kufizohet me Pakistaninin, Butan, Kinën dhe Nepalin		
○ Është ish-koloni Britanike		
○ Kryeqyteti është New Delhi		
○ 14 gjuhë zyrtare, kurse Hindi dhe Anglishtja janë gjuhët më të rëndësishme/të folura gjerësisht		
• Qendra Gjuhësore:	PS-BOTA-08	25 min



I është për Indi		
• Qendra Matematikore: Le të gjejmë rrugën tonë përreth	PS-BOTA-09	25 min
• Tema Qendrore Agra: Taj Mahal	PS-BOTA-10	25 min
• Qendra e Artit Joga	PS-BOTA-11	25 min
• Mbyllja në rreth		10 min

E enjte: Kenia

• Hapja në rreth Nkatha na mirëpret në Keni. Gjëja e parë për të ditur është që ne Keni është tepër e nxehtë jashtë! Mirë se vini Keni!		10 min
○ Kryeqyteti është Nairobi		
○ Liqeni Viktoria është në jugperëndim		
○ Mount Keni është maja e dytë më e madhe malore në Afrikë		
○ Kenia kufizohet me Somalinë, Oqeanin Indian, Etiopinë, Sudanin, Ugandën, dhe Tanzaninë		
○ Ekuatori është në Keni		
○ Ka 39 milionë banorë		
○ Ka 42 fise në Keni		
• Qendra Gjuhësore Kush jam unë?	PS-BOTA-12	25 min
• Qendra Matematikore Numërimi i kafshëve	PS-BOTA-13	25 min
• Tema Qendrore Gjeni rrugën tuaj për në shtëpi?	PS-BOTA-14	25 min
• Qendra e Artit: Bërja e flamujve	PS-BOTA-15	25 min
• Mbyllja në rreth		10 min

E premtë: Italia

- Hapja në rreth 10 min
Peter na mirëpret në Itali!
 - Italia gjendet në Evropën Jugore dhe kufizohet me Francën, Zvicrën, Austrinë, Slloveninë dhe Detin Mesdhe.
 - Ka 60.6 milion banorë; është vendi i 5 më i populluar në Evropë
 - Kryeqyteti është Roma
 - Gjuha është Italiane
 - Perandoria Romake ishte nga Italia
 - Vatikani është brenda Italisë

- Qendra Gjuhësore: PS-BOTA-16 25 min
Pompeii: P është për...
- Qendra Matematikore: PS-BOTA-17 25 min
Napoli: Bëni Pica
- Tema Qendrore PS-BOTA-18 25 min
Piza: Kulla e Pjerrët
- Qendra e Artit PS-BOTA-19 25 min
Romë: Statuja pozon
- Mbyllja në rreth 10 min



Rreth botës PS

Titulli:	Le ta takojmë João-n	Kodi:	PS-BOTA-01
Subjekti:	Kulturë - Qendra Gjuhësore	Koha:	25 min
Qëllimi i Aktivitetit:	Praktikoni leximin dhe të kuptuarit e leximit. Demonstroni përmes fotografive		
Përshkrimi /si të luajë:	<p>Një djalë i quajtur João ka rënë dakord për të na treguar Brazilin dhe të ndajë shtëpinë e tij, Rio de Janeiro, me ne. Lexoni me zë të lartë historinë e João-së.</p> <p><i>Përshëndetje. Emri im është João dhe vij nga Rio de Janeiro.</i></p> <p><i>Unë jetoj në Rio de Janeiro me nënën time, babën dhe tri motrat.</i></p> <p><i>Jeta është e bukur këtu, unë shkoj në shkollë dhe jam pjesë e një klubi futbollit mbasditeve. Unë shpresoj që një ditë të jemë një yll futboll.</i></p> <p><i>Por pjesa më e mirë e jetesës në Rio de Janeiro është festimi i karnavaleve çdo vit. Çdo vit në shkurt apo mars, Rio de Janeiro mbanë një ndejë shumë të madhe të quajtur Karnaval.</i></p> <p><i>Mbi një milion njerëz vijnë për të festuar me ne!</i></p> <p><i>Por pjesa më e mirë e karnavalit është parada Samba. Njerëzit vallëzojnë dhe këndojnë dhe ecin në rrugë në rroba të bukura! Pëlhurat janë të mbuluara në pupla, ar dhe rruaza kështu që e gjitha është shumë e bukur!</i></p> <p>Tani ndani klasën në 6 grupe. Shqyrtoni një linjë/seksion të tregimit me secilin grup dhe kërkoni nga ata të ilustrojnë pjesën e tyre. Shkruani linjën poshtë fotografisë dhe ngjitëni atë së bashku si një libër i ri për klasën tuaj.</p> <p>Nëse ju keni shumë fëmijë, kërkoni nga një grup që të bëj kopertinën!</p>		
Variacione:	Asnjë		
Pikat e Diskutimit:	A doni të shkoni në karnaval?		
Fjalori:	Merrni nga teksti		
Materiale:	Letër dhe markera		
Fletë pune:	Asnjë		
Referencat:	http://ezinearticles.com/?Rio-De-Janeiro-Carnival&id=232195 http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/country_profiles/1227110.stm http://totallycoolpix.com/2011/03/rio-de-janeiro-carnival-2011/		



Rreth botës PS

Titulli:	Forma	Kodi:	PS-BOTA-02
Subjekti:	Kulturë - Qendra Matematikore	Koha:	25 min
Qëllimi i Aktivitetit:	Që fëmijët të jenë në gjendje të identifikojnë format dhe emrat për objekte të ndryshme.		
Përshkrimi /si të luajë:	<p>* Zgjedhni forma të cilat janë të nivelit të përshtatshëm për nxënësit tuaj *</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Si një rreth, mbledhuni përreth dhe tregoni një foto të një formë të caktuar, për shembull katror. Pyetni fëmijët se si ata e dinë se çfarë formë është ajo. Flitni për atë që e bën një katror “katrorë”! 2. Shikoni 5 forma. 3. Pastaj jepni çdo fëmije një copë letër 4. Thuaj emrin e njëres prej formave dhe kërkoni nga fëmijë që ta vizatojnë atë dhe ta mbajnë atë lart. 5. Vazhdojnë të praktikoni deri sa t'i bëni të gjitha format 6. Pastaj ndani fëmijët në dy rreshta. Fëmiju i parë në çdo rresht do të garojë deri tek tabela dhe do të vizatojë formën të cilin ju thoni përderisa ata vrapojne 7. Kjo është një garë e vrapimit të shpejtë! 		
Variacione:	Zgjidhni forma të përshtatshme për moshën		
Pikat e Diskutimit:	Diskutimi përfshihet: Cilat janë emrat e formave?		
Fjalori:	Forma të ndryshme gjeometrike ... katror, rreth trekëndësh, diamanti, yll		
Materiale:	Vizatimet tuaja tëseçilës prej formave në një copë të madhe letre Letër dhe stilolaps për çdo fëmijë Tabela e bardhë		
Fletë pune:	Asnjë		
Referencat:	Asnjë		



Rreth botës PS

Titulli:	Emocionet dhe Krijimi i Maskave	Kodi:	PS-BOTA-03
Subjekti:	Kulturë - Tema Qendrore dhe Qendra e Artit	Koha:	50 min
Qëllimi i Aktivitetit:	Që fëmijët të eksplorojnë artizanatin dhe kulturën e Brazilit nga të kuptuarit e traditës së karnavaleve dhe mjeshtërisë së maskave.		
Përshkrimi /si të luajë:	<p>João merr A&L në një fabrikë të maskë-bërjes. Maskat janë shumë të rëndësishme në traditën e karnavalit si diçka për të veshur dhe për të festuar në parada. Maskat kanë plot ngjyra, forma, dizajne dhe tregime.</p> <p>Të gjitha maskat tregojnë emocione! Cilat janë emocionet? Mund të listoni disa? I lumtur, i trishtuar, i frikësuar, i shqetësuar, i ngacmuar, i hutuar, etj. Shkruani emocionet që ata I thonë në tabelë. Kur fëmijët nuk mund të mendojnë më shumë, kthehuni tek lista. Lexoni çdo fjalë me zë të lartë dhe kërkoni që me radhë fëmijët të vizatojnë nga një fytyrë për fjalë: një fytyrë të trishtuar pranë fjalës 'trishtuar'. Pasi që secili fëmijë të ketë vizatuar një fytyrë, pyetni kur ka qenë një moment kur ata kanë qenë ____ (plotësoni me emocion).</p> <p>Le t'i praktikojmë emocionet. A mund të gjithë në dhomë të bëjnë një fytyrë të trishtuar? Një fytyrë të lumtur? Një fytyrë të shqetësuar. Vazhdo me të gjitha emocionet të listuara.</p> <p>Le të lëshojmë muzikë dhe të vallëzojmë! Tregoni fëmijët se kur ndalet muzika, ti do ta thuash një emocion. Ata duhen të përdorin gjithë trupin e tyre: fytyra, duart, këmbët, trupin për të treguar emocionin dhe të ngrihen! Pasi secili ka emocionin e saktë, filloni përsëri muzikën.</p> <p>Ok - tani ne i kuptojmë emocionet, zgjidhni një emocion për maskën tuaj. Shko rreth rrethit dhe tregoni se çfarë emocion ju doni të bëni.</p> <p>Dhe tani është radha juaj për të bërë një maskë! Jepni çdo fëmijë një te prerë të një maske. Mbuloni tavolinën apo kryeni e aktivitetin jashtë. Jepni fëmijëve vezullim, markera, ngjitës, pupla dhe letër shtesë.</p> <p>Kur fëmijët kanë kryer, bashkëngjitni një varg në mënyrë që ata mund ta venë maskën në fytyrë.</p> <p>Pasi të gjithë fëmijët kanë kryer, ecni përreth me maskat tuaj të reja!</p>		
Variacione:	Asnjë		
Pikat e Diskutimit:	<p>Pse e keni ngjyrosur maskën tuaj në atë mënyrë? Është maska juaj një maskë e lumtur? Çfarë forma keni vizatuar në maskën tuaj?</p>		



Fjalori:	I lumtur, i trishtuar, i frikësuar, i shqetësuar, i ngacmuar, i hutuar etj.
Materiale:	<ul style="list-style-type: none"> • Shabllonet e maskave të prera për secilin fëmijë (PHO-WORLD-01) • Gërshëre • Markera • Ngjitës • Vezullues • Objektet për kolazh: pupla, rruaza etj • Varg • Vrimë shpues • Fotot e maskave karnavalore
Fletë pune:	Asnjë
Referencat:	http://www.activityvillage.co.uk/mask_templates.htm - prerësit e maskave



Rreth botës PS

Titulli:	SH-B-A	Kodi:	PS-BOTA-04
Subjekti:	Kulturë - Qendra Gjuhësore	Koha:	25 min
Qëllimi i Aktivitetit:	Që fëmijët të praktikojnë dëgjimin aktiv dhe të mësojnë për legjenda		
Përshkrimi /si të luajë:	<p>Billy ju mirëpret në Shtetet e Bashkuara të Amerikës! Në anglisht ne zakonisht shkruajmë emrin e vendit, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si SHBA - shkurt! A mund të shkruani këto tri shkronja?</p> <p>Praktikoni shkrimin e 'SHBA' si shkronja të mëdha dhe të vogla.</p> <p>Ndani fëmijët në tri grupe: grupi SH, grupi B dhe grupi A. Një mësues / udhëheqës do të jetë me nga një grup. Tani, si një grup, merrni një copë të madhe të letrës dhe për 5 minuta vizatoni nga një shkronjë të bukur (SH, B, ose A) në mes të letrës.</p> <p>Kur koha të kryhet, keni 5 minuta për të thuni sa më shumë fjalë me shkronjat SH, B, ose A që ju mund të mendoni. Mësuesi / Udhëheqësi duhet të shkruaj fjalën rreth shkronjës.</p> <p>Pas 5 minutash, numëroni sa fjalë ka secili ekip për të parë kush është fitues!</p>		
Variacione:	Në qoftë se vetëm dy anëtarë të stafit janë në parashkollore zgjidhni dy nga tre shkronjat.		
Pikat e Diskutimit:	Përfshihet më lartë		
Fjalori:	Fëmijët të vijnë me lidhje të SH-B-A		
Materiale:	Letër të Madhe, markera, stilolaps		
Fletë pune:	Asnjë		
Referencat:	Asnjë		



Rreth botës PS

Titulli:	13 Shtetet	Kodi:	PS-BOTA-05
Subjekti:	Kulturë - Qendra Matematikore	Koha:	25 min
Qëllimi i Aktivitetit:	Që fëmijët të praktikojnë numërimin e sasive të ndryshme.		
Përshkrimi /si të luajë:	<p>A&L duan të sigurohen që ne e dimë se ku jemi! Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë një vend shumë i madh me 50 shtete! Këto janë shumë shtete dhe një numër shumë i madh për të numëruar! Por, kur filloi Amerika, ajo ka pasur vetëm 13 Shtete!</p> <p>A mund të numëroni deri në 13? Numëroni së pari si një rreth së bashku dhe më pas si një rreth një nga një.</p> <p>Le të shkruajmë numri. Shumë Shtete duken si katrorë. Dhe trembëdhjetë të parat ishin pothuajse në një rend! A mund të vizatoni një rresht, nga maja e deri në fund me 13 shtete në krye?</p> <p>Tani le të shikojmë ne trembëdhjetë shtetet e vërteta. A mund të vendosni ato së bashku? Jepni fëmijëve në çifte enigmën e 13 Shtetet origjinal dhe i pyet ata për ta vënë atë së bashku.</p>		
Variacione:	Nëse lejon koha ju mund të vazhdoni të praktikoni numrin 13 dhe të gjithë numrat para tij ose ngjyrosni enigmën e shteteve.		
Pikat e Diskutimit:	Asnjë		
Fjalori:	Shtetet		
Materiale:	Asnjë		
Fletë pune:	13 copë të enigmës së shteteve të prerë dhe të gatshëm (PHO-WORLD-02)		
Referencat:	Asnjë		

Rreth botës PS

Titulli:	Dielli dhe Hëna	Kodi:	PS-BOTA-06
Subjekti:	Kulturë - Tema Qendrore	Koha:	25 min
Qëllimi i Aktivitetit:	Për fëmijët të dëgjojnë një histori popullore		
Përshkrimi /si të luajë:	<p>Billy na tregon se ka shumë lloje të ndryshme të njerëzve në Amerikë. Ku ai jeton ka një grup Indianësh, njerëzit e parë që kanë ardhur në Amerikë! Fqinji i tij është një indian i vjetër Hopi. Kur Billi i tha fqinjit të tij se ne ishim duke vizituar, fqinji tha se ai mund të na tregojë një histori rreth asaj se nga ku ai mendon se dielli dhe hëna kanë ardhur. A doni të dëgjoni?</p> <p>Uluni në një rreth dhe lexojuni fëmijëve historinë me zë të lartë.</p> <p>Sigurohuni që të pyesni pyetje të kuptuarit gjatë gjithë kohës.</p>		
Variacione:	Asnjë		
Pikat e Diskutimit:	<p>Nga ku mendoni se vijnë dielli dhe hëna? A e dini ndonjë histori popullore?</p>		
Fjalori:	Merrni nga tregimi		
Materiale:	(PHO-WORLD-03)		
Fletë pune:	Asnjë		
Referencat:	http://www.indigenouspeople.net/howthegr.htm		



Rreth botës PS

Titulli:	Bëni Diellin dhe Hënën	Kodi:	PS-BOTA-07
Subjekti:	Kulturë - Qendra e Artit	Koha:	25 min
Qëllimi i Aktivitetit:	Që fëmijët të krijojnë atë që dëgjojnë		
Përshkrimi /si të luajë:	Historia e fqinjët të Billy është shumë emocionuese. A mund ne të bëjmë hënën dhe diellin ashtu si indianët e kanë bërë? Ri-lexoni udhëzimet në tregim. Së pari bëni hënën dhe pastaj diellin.		
Variacione:	Prisni rrethet përpara nëse është e nevojshme		
Pikat e Diskutimit:	A do të kishit bërë diellin dhe hënën ndryshe? A duken kështu në qiell?		
Fjalori:	Merrni nga teksti		
Materiale:	Letër të bardhë, markera të zinj, gërsërë, markera të verdhë, varg, rruaza të verdha (të mëdha), markera		
Fletë pune:	Asnjë		
Referencat:	Asnjë		



Rreth botës PS

Titulli:	I është për Indi	Kodi:	PS-BOTA-08
Subjekti:	Kulturë - Qendra Gjuhësore	Koha:	25 min
Qëllimi i Aktivitetit:	Qër fëmijët të praktikojnë shkronjën I		
Përshkrimi /si të luajë:	<p>Përshëndetje! Unë quhem Satya. Satya do të thotë 'e vërtetë' në gjuhën e lashtë sanskritishte. Unë vijë nga India, i cili është një shtet i madh në Azi dhe ka formën e shkronjës 'V'. A mund të përdorni duart tuaja për të bërë një V?</p> <p>Ta themi përshëndetjen në Hindi: Namaste!</p> <p>Ejani dhe bashkohuni me mua në një turne rreth këtij shteti magjik shumëngjyrësh. Vendi im i mrekullueshëm quahet Indi. Me cilën shkronjë fillon? Shkronjë n"l"!</p> <p>Le të shkruajmë shkronjën "l". Me shkronjë të madhe dhe me të vogël. Çfarë fjale tjetër fillon me shkronjën 'l'?</p> <p>Tani, si në një grup, a mund të përdorni trupat tuaj për të bërë shkronjën 'l'?</p> <p>Cilat janë shkronjat e tjera në fjalën INDIA? Shkruani secilën prej tyre.</p> <p>A mund të vizatoni dhe të ngjyrosni Indinë me fjalën INDIA të shkruar brenda?</p>		
Variacione:	Asnjë		
Pikat e Diskutimit:	Asnjë		
Fjalori:	Indi		
Materiale:	Letër dhe stilolaps		
Fletë pune:	Prerje të shtetit të Indisë (PHO-WORLD-04)		
Referencat:	http://blog.hry.in/wp-content/uploads/2007/05/india.jpg		

Rreth botës PS

Titulli:	Le të gjejmë rrugën tonë përreth	Kodi:	PS-BOTA-09
Subjekti:	Kulturë - Qendra Matematikore	Koha:	25 min
Qëllimi i Aktivitetit:	Që fëmijët të praktikojnë anët/kahjet: E majta dhe e djathta		
Përshkrimi /si të luajë:	<p>Satya na tregon se India është një vend shumë i madh, por ne do përpiqemi të gjejmë rrugën tonë përreth.</p> <p>Vizatoni në terren/tokë me varg ose shkumës skicën e Indisë, një formë diamanti. Ne do ecim në të gjithë Indinë nga qyteti në qytet. Shto qytetet: Nju Delhi, Mumbai, Bangalore, Darjeeling, Ccutta, Agra, dhe Dandi në hartë. Theksoni qytetet në "hartën" dhe emërtoni ato objekte të rëndësishme nga qytetet:</p> <p>Nju Delhi: një ndërtesë e madhe Mumbai: një video Bangalore: një byzylyk Darjeeling: çaj Calcutta: Nëna Terezë Agra: Taj Mahal Dandi: Kripë</p> <p>Para se të lëvizim, ne duhemi të dallojmë të djathtën tonë nga e majta! Praktikoni kthimin djathtas dhe majtas.</p> <p>Tani, ne do të fillojmë në Nju Delhi dhe do të japim udhëzime fëmijëve duke ecur në këmbë në një qytet të ri. A mund ata të supozojnë se ku po shkojmë?</p>		
Variacione:	Asnjë		
Pikat e Diskutimit:	Asnjë		
Fjalori:	Djathtas dhe Majtas		
Materiale:	Shkumës ose Varg Objektet për të shënuar vende		
Fletë pune:	Asnjë		
Referencat:	http://blog.hry.in/wp-content/uploads/2007/05/india.jpg https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/in.html		

Rreth botës PS

Titulli:	Agra: Taj Mahal	Kodi:	MS-BOTA-10
Subjekti:	Kulturë - Tema Qendrore	Koha:	25 min
Qëllimi i Aktivitetit:	Që fëmijët të ushtrojnë si të vizatojnë si ekip		
Përshkrimi /si të luajë:	<p>Satya ju mirëpret në Taj Mahal. Satya na tregon se Taj Mahal është ndërtuar nga perandori Shah Jahan për gruan e tij të tretë kur ajo vdiq. Ajo ishte tepër e bukur! Ndërtesa më e rëndësishme të Taj Mahal-së është e gjitha e bardhë dhe e zbukuruar. Le të shikojmë një foto.</p> <p>Merrni një copë të madhe të letrës të përgatitur me një skicë të Taj Mahal-së.</p> <p>Shpjegoni fëmijëve se ata duhen të punojnë së bashku për të vizatuar dhe të ngjyrosur Taj Mahal-in. Ne do përdorim letër të gjelbër dhe markera për kopshtin. Ne kemi topa pambuku për t'i ngjitur në Taj Mahal. Fëmijët duhen të ndajnë punët në mënyrë që ata të gjithë kenë diçka për të bërë.</p>		
Variacione:	Asnjë		
Pikat e Diskutimit:	<p>A dini për ndonjë varrezë të bukur?</p> <p>A duket letra e juaj Taj si aTaj-i i vërtetë.</p>		
Fjalori:	Varrezë		
Materiale:	<p>Letër e Madhe, markera, letër e gjelbër, ngjitës, topa pambuku.</p> <p>Pic of Taj (PHO-WORLD-05)</p>		
Fletë pune:	Asnjë		
Referencat:	http://en.wikipedia.org/wiki/Taj_Mahal		



Rreth botës PS

Titulli:	Joga	Kodi:	PS-BOTA-11
Subjekti:	Kulturë - Qendra e Artit	Koha:	25 min
Qëllimi i Aktivitetit:	Që fëmijët të praktikojnë ndonjë aktivitet fizik		
Përshkrimi /si të luajë:	<p>Satya pastaj na merr për të vizituar një guru. Guru është një person i cili ka studiuar joga për shumë shumë e shumë vite. Joga është një sport për zgjatje I cili, Indianët besojnë, është shumë I shëndetshëm.</p> <p>Lëshoni një muzikë të qetë ose dilni jashtë dhe bëni një rreth. Mësoni fëmijët disa lëvizje themelore joga. Pastaj shkoni përreth dhe kërkoni nga fëmijët që të bëjnë lëvizjet/zgjatjet e tyre! Bëni zgjatjet me çdo fëmijë.</p>		
Variacione:	Asnjë		
Pikat e Diskutimit:	A ndjeheni më të shëndetshëm tani?		
Fjalori:	Joga, guru		
Materiale:	Asnjë		
Fletë pune:	Asnjë		
Referencat:	Asnjë		





Rreth botës PS

Titulli:	Kush jam unë?	Kodi:	PS-BOTA-12
Subjekti:	Kulturë - Qendra Gjuhësore	Koha:	25 min
Qëllimi i Aktivitetit:	Që fëmijët të ushtrojnë ta prezantojnë veten.		
Përshkrimi /si të luajë:	<p>Nkatha na fton në Nairobi!</p> <p><i>"Unë jam Nkatha. Unë jam 5 vjec. Unë jetoj në Nairobi, që është kryeqyteti i Kenias. Unë jetoj në një shtëpi me nënën time, babën tim, dy motrat e mia, 6 qentë, 3 macet, 3 dhi dhe një shtëpiake. Me kë jetoni ju?</i></p> <p><i>Çdo ditë shkoj në foshnjore/gadimore. Në foshnjore unë mësojë në dy gjuhë: anglisht dhe suahilisht. Ndonjëherë unë ngatërroj këto gjuhë, por zakonisht, më kujtohet cila është cila. A keni këtë problem? Ne gjithashtu mësojmë për numra dhe për kafshët.</i></p> <p><i>Pasditëve, mua më pëlqen të luaj me miqtë e mi dhe të hamë shumë ushqime. Ne hamë shumë mish pule, fruta, dhe bukë të veçantë të quajtur Chapati. Çfarë hani ju? "</i></p> <p>Tani, është rradha juaj për të prezantuar veten. Shkoni përreth dhe prezantohuni me Nkatha. Tregoni emrin tuaj, sa vjet keni, me kë jetoni, çfarë keni mësuar në foshnjore, atë që ju bëni në kohën tuaj të lirë dhe çfarë ju pëlqen të hani.</p> <p>Tani si një grup, shkruani një letër Nkatha-së duke i treguar për Kosovën dhe shtëpitë tuaja. Ilustroni letrën.</p>		
Variacione:	Fëmijët duhen të vizatojnë atë që po i tregojnë Nkatha-së dhe t'ia tregojnë grupit/		
Pikat e Diskutimit:	Përfshihet më lartë		
Fjalori:	Kryeqytet, Dhi ...		
Materiale:	Letër, markera		
Fletë pune:	Asnjë		
Referencat:	Asnjë		

Rreth botës PS

Titulli:	Numërimi i Kafshëve	Kodi:	PS-BOTA-13
Subjekti:	Kulturë - Matematikë	Koha:	25 min
Qëllimi i Aktivitetit:	Që fëmijët të praktikojnë numërimin		
Përshkrimi /si të luajë:	<p>Nkatha dëshiron të na tregojë pjesët më të mira Nairobi ... kështu që ajo dëshiron të na marrë te Parku Kombëtar në Nairobi. Parku Kombëtar është një park safari. A e dini se çfarë është një park safari?</p> <p>Në safari park ka shumë kafshë. Çfarë kafshë mendoni se ka? Vetëm disa nga shumë kafshë janë:</p> <p>Antilopat, Majmunët, Zogjtë, Babunët, Buffalot, En'am, Çitat, krokodilat, Lejlekët me Kurorë, Shqiponjat, Elefantët, Gazelat, Gjirafat, Hipopotamuset, Çakallët, Leopardët, Luanët, Strucët, Zebrat, Rinot, delet, dhitë, gjarpërinjtë , hijenat, kafshë të egra.</p> <p>Mbani lart një foto të secilit prej këtyre kafshëve që fëmijët të mësojnë emrin e kafshës.</p> <p>Tani le të praktikojmë numërimin ... 1, 2, 3, 4, etj. Numëroni kafshët.</p> <p>Tani ne jemi duke shkuar në safari - sa prej këtyre kafshëve mund të gjeni? Fshihni fotot e kafshëve të ndryshme përreth dhomës dhe shkoni në safari. Sa shumë kafshët mund të gjeni? Sa nga çdo lloj i kafshëve mund të gjeni?</p>		
Variacione:	Në qoftë se kjo është një ditë e bukur dhe ju keni hapësirë jashtë, shkoni në ekspeditë gjuetive.		
Pikat e Diskutimit:	Cila kafshë të egra ecin përreth në qytetin tuaj? A ka Gjirafa dhe majmunë?		
Fjalori:	Antilopat, Majmunët, Zogjtë, Babunët, Buffalot, En'am, Çitat, krokodilat, Lejlekët me Kurorë, Shqiponjat, Elefantët, Gazelat, Gjirafat, Hipopotamuset, Çakallët, Leopardët, Luanët, Strucët, Zebrat, Rinot, delet, dhitë, gjarpërinjtë , hijenat, kafshë të egra.		
Materiale:	Fotot të fshehura të kafshëve		
Fletë pune:	Fotot e kafshëve me emra		
Referencat:	Asnjë		

Rreth botës PS

Titulli:	Gjeni rrugën tuaj për në shtëpi	Kodi:	PS-BOTA-14
Subjekti:	Kulturë - Tema Qendrore	Koha:	25 min
Qëllimi i Aktivitetit:	Qërfëmijët të gjejnë shtëpinë e tyre		
Përshkrimi /si të luajë:	<p>Duke ecur në këmbë rreth qytetit me Nkatha, ne fillojmë të shohim disa burra duke ecur në këmbë me batanije të kuqe mbi krahë dhe me një shkop të gjatë. Ata kanë qafore të bukura të kuqe dhe rrathë. Kush janë ata?</p> <p>Nkatha na tregon se ata janë Maasi. Maasi janë një fis i Kenias që jetojnë në jug. Ata nuk jetojnë në një vend, por udhëtojnë rreth e rreth dhe gjejnë shtëpi të ndryshme.</p> <p>Fëmijët Maasi shkojnë në shkollë me konvikt - ata jetojnë në shkollë. Kur ata vijnë në shtëpi 2 muaj më vonë, ata duhen të gjejnë shtëpinë e tyre të re.</p> <p>Një nga miqtë e Nkatha është gati për të udhëtuar në shtëpi dhe na fton për t'u bashkuar. Prindërit e mikut të Nkathas kanë lënë shënime nëpër rrugë ashtu që miku i Nkathas të gjejë shtëpinë.</p> <p>Ose në klasë ose jashtë, varni shënime me të dhëna të tilla si tre pemë poshtë ose nën tavolinën e dytë mund të gjeni shënimin tjetër.</p> <p>Sigurohuni që ka një shtëpi në fund të udhëtimit.</p>		
Variacione:	Jashtë apo brenda		
Pikat e Diskutimit:	<p>A do të të pëlqente lëvizesh gjatë gjithë kohës?</p> <p>Doni të jetoni në vende të ndryshme gjatë gjithë kohës?</p>		
Fjalori:	Fis, batanije, qafore, rrathë, shkop		
Materiale:	Letër dhe lapsa për shënime		
Fletë pune:	Asnjë		
Referencat:	Asnjë		

Rreth botës PS

Titulli:	Bërja e flamujve	Kodi:	PS-BOTA-15
Subjekti:	Kulturë - Qendra e Artit	Koha:	25 min
Qëllimi i Aktivitetit:	Që fëmijët të mendojnë për dizajnet e flamujve		
Përshkrimi /si të luajë:	<p>Duke ecur në këmbë rreth Nairobi, vërejmë se kenianët janë shumë krenarë me ngjyrat e tyre kombëtare dhe kanë shumë këmisha, rrathë etj me ngjyrat e tyre kombëtare. Pra, ne vendosim për të pyetur Nkathan se çfarë do të thonë ngjyrat të flamurit kombëtar.</p> <p>Hidhni një sy flamurit kombëtar. Ngjyrat janë: Kuqe - gjak të derdhur në luftën për liri Zi - për popullin Gjelbër - për tokën E bardhë - për paqe Mburoja dhe dy shtiza - Një mburojë Maasi për të mbrojtur vlerat e përmendura më lart</p> <p>Tani është rradha juaj ... Si do duket flamuri juaj? Çfarë vlerash do të përfaqësojë flamuri juaj? Bëni atë!</p>		
Variacione:	Asnjë		
Pikat e Diskutimit:	Si duket flamuri kosovar? Pse? Cilat vlera janë të rëndësishme? A janë flamujt gjithmonë përfaqësues të mire të kombit?		
Fjalori:	Mburojë, shtiza, vlera, krenar, ngjyrat kombëtare, luftë, paqe		
Materiale:	Letër ndërtimi, markera, ngjitës, letër		
Fletë pune:	Flamuri i Kenias (PHO-WORLD-06)		
Referencat:	http://en.wikipedia.org/wiki/Flag_of_Kenya		

Rreth botës PS

Titulli:	Pompeii: P është për ...	Kodi:	PS-BOTA-16
Subjekti:	Kulturë - Qendra Gjuhësore	Koha:	25 min
Qëllimi i Aktivitetit:	Që fëmijët të praktikojnë shkronjën 'P'		
Përshkrimi /si të luajë:	<p>Pjeteri na fton të në Itali! Peter është 5 vjeç dhe jeton në Pompei. Pompei ishte me të vërtetë i famshëm për shkak të një vullkani, por vullkani nuk do të shpërthejë tani. Peter jeton me nënën, babën dhe vëllain në një banesë. Ata nuk kanë kafshë.</p> <p>Me cilën shkronjë fillon emri i Peterit? 'P'! Le të praktikojmë shkrimin me shkronjë të madhe dhe të vogël.</p> <p>Peter është i lumtur që emri i tij fillon me "P", sepse kjo është letra e ushqimit të tij të preferuar, PICA dhe vendlindjes së tij, Pompei. A mund ta shkruani fjalën PICA? Gjithashtu, gjyshërit e tij jetojnë në Pisa, një tjetër 'P'. Çfarë tjetër fillon me 'P'?</p> <p>Tani, merrni një qese me fjalë që kanë të bëjë me ushqimin italian ... domate, makarona, pica, mocarela, specia, bukë, verë, brochette, ravioli, makarona, shpageta, kërpudha, spec djegës, peshk, etj</p> <p>Kërkoni nga fëmijët që me radhë t'i tërheqin nga një fjalë nga qesja dhe të lexojnë atë. Grupi duhet të vendosë nëse ajo fillon me 'P' apo jo.</p>		
Variacione:	Asnjë		
Pikat e Diskutimit:	<p>A ju pëlqen pica?</p> <p>Cili është ushqimi juaj i preferuar?</p>		
Fjalori:	Çfarëdo që ju vendosni në karta		
Materiale:	Letër, stilolaps dhe enë për të zgjedhur kartat		
Fletë pune:	Asnjë		
Referencat:	Asnjë		



Rreth botës PS

Titulli:	Napoli: Bëni Pica	Kodi:	PS-BOTA-17
Subjekti:	Kulturë - Qendra Matematikore	Koha:	25 min
Qëllimi i Aktivitetit:	Që fëmijët të praktikojnë matjen e artikujve		
Përshkrimi /si të luajë:	<p>Peter vendosi që ndalesa jonë e ardhshme në turin e Italisë duhet të jetë Napoli, shtëpia e picës. Nuk ka udhëtim të plotë rreth Italisë pa një ushqim të shijshëm. Pica është bërë fillimisht në Napoli por tani kemi ngrënë në të gjithë botën.</p> <p>Jepini çdo fëmijë njëpicë të para-mbështjellë / apo jepni çdo grupi një pica-bukë të para-mbështjellë). Tani ne do të praktikojmë numrat me perime dhe djathë për të vënë mbi të.</p> <p>Së pari të gjithë duhet të vënë 2 (ose ndryshim të përshtaten nga madhësia e picës suaj) lugë salcë domatesh. Numëroni së bashku.</p> <p>Pastaj vënë mbi të tri grushte djathë (ose ndryshoni varësisht nga madhësia e picës suaj) Vazhdo me udhëzimet se sa domate, specia, ullinj etj duhet vënë në picë. Pastaj piqni atë!</p>		
Variacione:	Asnjë		
Pikat e Diskutimit:	Çfarë zakonisht vendosni në picën tuaj?		
Fjalori:	Domate, djathë, specia, ullinj etj		
Materiale:	<p>Matëse gatimi, lugë çaji, lugë, enë për përzierje, thika, miell, ujë të ngrohtë, maja, kripë, vaj ulliri, djath, salcë domatesh, domate, perime</p> <p>Udhëzime për brume të Pica-s: Vendosni miellin në një enë të madhe. Shto kripë dhe tharm, dhe përzierni mirë me një lugë druri. Ngadalë derdh 16 lugë me ujë të ngrohtë ndërsa përzierni. Shto vajin e ullirit dhe vazhdoni duke përzier derisa brumi të bëhet kompakt dhe elastik. Shto pak miell në qoftë se mielli është shumë i lagur apo ujë në qoftë se është shumë i thatë. Gatuj për rreth 8 minuta dhe formo një top dhe vendosni në një tas të shkrirë. Mbulo dhe lere të rritet në temperaturë dhome derisa dyfishohet madhësia (rreth 1 orë). Ngroh paraprakisht furrën në 280 °. Bëni me miell tavolinën, dhe vendosni brumin e fryrë mbi. Ndaj në 4 pjesë të barabarta dhe në formë topa. Mbulo dhe le pushim për rreth gjysmë ore. Rrokullisi në disqe shumë të hollë dhe të pastrohen ata vaj ulliri. Vendosni secilin disk mbi një lëvozhgë pjekje qit përbërës nga zgjedhja e juaj dhe vendosni në furrë. Piqni derisa bëhet pak e fortë rreth 5 deri në 8 minuta. Shërbehet për 4 persona.</p>		
Fletë pune:	Asnjë		
Referencat:	Recetë Personale nga Italia		




Rreth botës PS


Titulli:	Piza - Kulla e Pjerrët	Kodi:	PS-BOTA-18
Subjekti:	Kulturë - Tema Qendrore	Koha:	25 min
Qëllimi i Aktivitetit:	Që fëmijët të ndërtojnë Kullen e Pjerrët të Pizës në grupe		
Përshkrimi /si të luajë:	<p>Peter ka vendosur të na marrë në Veri për të vizituar një nga ndërtesat më të famshme të Italisë - Kulla e Pjerrët e Pizës. Sot Kulla e Pjerrët është një ndërtesë e madhe që lakohet në një anë. Ajo një kohë ka qëndruar drejtë por tani është duke u zhytur në tokë. Oh jo! Mund të ndihmoni?</p> <p>Babai i Peterit është një arkitekt. Ai dëshiron të dijë nëse ju mund të kopjoni Kullën e Pjerrët, por ta bëni atë të drejtë!?</p> <p>Në fillim të dhomës është një model i kullës origjinale në blloqe me ngjyrë të veçantë.</p> <p>Në grupe nga 3 përdorni blloqet tuaaj për të kopjuar kullën. Sigurohuni që të merrni ngjyrat dhe numrin e blloqeve saktë!</p>		
Variacione:	Bëni atë një garë!		
Pikat e Diskutimit:	<p>A do të ishit ngjitur në një kullë që ishte pjerrët?</p> <p>A dini për ndonjë ndërtesë tjetër që është të pjerrët?</p>		
Fjalori:	Pjerrët, lakohet, ndërtimi		
Materiale:	Blloqet e Ndërtimit (shumë)		
Fletë pune:	Asnjë		
Referencat:	http://www.italyguides.it/us/pisa/leaning_tower.htm http://en.wikipedia.org/wiki/Leaning_Tower_of_Pisa		


Rreth botës PS


Titulli:	Romë: Statuja Pozon	Kodi:	PS-BOTA-19
Subjekti:	Kulturë - Qendra e Artit	Koha:	25 min
Qëllimi i Aktivitetit:	Që fëmijët të shfaqin emocione të lidhura me veprimet		
Përshkrimi /si të luajë:	<p>Pastaj Peter na merr në kryeqytetin ROMË! Roma është e bukur dhe ka art kudo. Roma ka shumë statuja që pothuajse duken të vërteta. Artistët e Romës dëshiruan që të tregonin emocionet me artin e tyre.</p> <p>Cilat janë emocionet? Rishikoni ato nga mësimet në fillim të javës</p> <p>Tani ne do të përpiqemi të të bëhemi si statuja të gjalla/statuja të një momenti të kapur në kohë. Por shumica e Statujave në Romë nuk tregojnë vetëm një person, por shumë njerëz. Pra ne do të bëhemi statuja grupore. Imagjinoni një situatë ... vrapimi në shi, ulur në shkollë, duke hipur në një autobus ... dhe e tërë klasa duhet ta bëjë atë si një statujë e ngrirë.</p>		
Variacione:	Asnjë		
Pikat e Diskutimit:	Si mund të bëni statuja të gjalla / të ngrira në kohë? Çfarë emocione keni treguar sahere që jeni ngrirë?		
Fjalori:	Merrni nga aktiviteti		
Materiale:	Asnjë		
Fletë pune:	Asnjë		
Referencat:	Asnjë		


(PHO-WORLD-01)

























(PHO-WORLD-02)



(PHO-BOTA-03)

Si Shefat të Mëdha kanë bërë Hënën dhe Diellin

Njëherë një kohë, njerëzit tanë të pare që dolën nga fshatrat e botës së krimit nuk kishin diell. Nuk kishin as hënë. Ajo ishte vetëm e errët dhe e ftohtë. Ata kërkuan vështirë për dru zjarri, por sepse ishte aq e errët, ata nuk mund të gjejnë atë!

Një ditë, ata panë dritë larg. Një burrë trim tha se ai do të shkojë të shoh se nga erdhi drita. Kur ai u afrua dritës, ai ka par një fushë të vogël të mbushur me misër, fasule, kungull, shalqi dhe ushqime të tjera. Por përreth gjithë fushës kishte zjarr!

Njeriu nuk e dinte se çfarë të bëjë! Por pastaj, ai ka par një i huaj në këmbë përpara tij. I huaji ishte i veshur me gjerdan të kaltër dhe një palë vathë të kaltër.

Pastaj i huaji foli: "Kush jeni ju?"

"Populli im dhe unë kemi ardhur nga bota e shpellave më poshtë," tha njeriu i huaj. "Është shumë e errët në shpella. Ne jemi të uritur dhe të ftohtë. Unë kam ardhur në kërkim të dritës për të ndihmuar popullin tim. Unë pashë një dritë dhe kam ndjekur këtu. Kush jeni ju?"

"Emri im është Skelet. Kjo është fusha ime." tha i huaj. Ai u ndje keq për njeriun dhe i dha pak ushqim. Deri sa ata folën, i huaji vendosi se ai donte të ndihmojë njeriun dhe popullin e tij. Ai u ndje keq se ata ishin të uritur dhe ftohtë. "Tani kthehuni tek familjet tuaja dhe sjellë ata në fushën time."

Njeriu u kthye te populli i tij dhe i mori shumë ditë, por ata të gjithë dolën në fushën që ai burri kishte gjetur. Kur të gjithë njerëzit kishin ardhur, Skeleti iu dha atyre bukë në fushën e tij. Populli ndërjuan zjarre për veten e tyre dhe ishin të lumtur, sepse ata kishin dritë dhe ushqim.

Më vonë, skeleti ndihmoi popullin për të mbjellë fushat e tyre dhe të bëjnë zjarre. Populli ishin shumë të lumtur! Por një ditë, populli vendosi se kishte ardhur koha për tu larguar: "Tani ne duhet të shkojmë përpara," tha populli. "Ne duam të gjejmë një vend ku ne do të jetojmë gjithmonë."

Por, larg nga zjarret ende ishte shumë errët. Shefat të Mëdha, në një këshill me Skeletin, vendosën të bëjnë një hënë si atë që kishin.

Ata morën pjesë të lëkurës së kafshëve dhe prenë atë në një rreth të madh. Ata zgjatën rrethin fort mbi hoop-in e bërë nga druri dhe pastaj pikturuan atë me kujdes me bojë të bardhë. Kur ajo ishte e thatë, atë pikturuan skajet me ngjyrë të zezë.

Atëherë tërë populli mbajti rrethin dhe filluan të lëkundin atë derisa ai fluturoi nga duart e tyre dhe shkoi në qiell.

Njerëz e panë, dhe papritmas kanë par një dritë në qiell. Drita filloi me u bë më e ndritshme dhe më e ndritshme. Ata kishin hënë!

Hëna ishte e mrekullueshme, ai i dha popullit pak dritë. Por kjo nuk ishte dritë të mjaftueshme. Populli nuk mund të shihnin shumë mirë dhe ende ishte ftohtë.

Pra, përsëri Shefat të Mëdha mbajtën një këshill me Skeletin, dhe përsëri vendosën që duhet të bëhet diçka. Këtë herë, do të bëjnë një diell!

Ata prenë një rreth të madh përsëri. Ata e zgjatën atë deri sa ishte i madh. Por në këtë kohë, në vend që të pikturojnë atë të bardhë, vendosën të pikturojnë atë të verdhë. Ata pikturuan sytë dhe gojë në diskun dhe zbukuruan ballin me ngjyra që Shefat e Mëdha vendosën se do sjellë fat. Pastaj mbjellën grurë nëpër skajet në vend që të pikturojnë atë zi.

Kur ai ishte i kryer, përsëri, të gjithë njerëzit filluan të lëkundin rrethin deri sa ai fluturoi në qiell.


Të gjithë populli shikuan atë me kujdes. Si shikuan, kanë par një dritë në lindje si të ishte zjarr ende duke djegur. Shpejt dielli i ri u ngrit dhe ka ngrohur tokën me rrezet e mirësisë së saj.

Tani me hënën duke ndër dritë në tokë gjatë natës dhe diellin duke ndër dritë dhe ngrohtësi gjatë ditës, të gjithë njerëzit vendosën se ata mund të lëvizin për të gjetur vend të mirë për të jetuar.

(PHO-WORLD-04)



(PHO-WORLD-05)



(PHO-WORLD-06)



<http://www.freeonlinepicture.org/flag-of-kenya/>



ndezja



Ndezja. A&L na ftojnë një aventurë në hapësirën e jashtme. Ne do të udhëtojmë me raketa dhe anije kozmike në hënë për të udhëtuar rreth e rreth dhe pastaj do të kthehemi. Pra, përgatituni për ndezje...

E hënë: Përgatitjet për Hapësirë

- | | | |
|--|-------------|--------|
| • Hapja në rreth | | 10 min |
| • Qendra Gjuhësore:
H është për Hapësirë | PS-SPACE-01 | 25 min |
| • Qendra Matematikore
Le të përgatitemi | PS-SPACE-02 | 25 min |
| • Tema Qendrore
Dizejnoni një kostum astronauti | PS-SPACE-03 | 25 min |
| • Qendra e Artit
Garat | PS-SPACE-04 | 25 min |
| • Mbyllja në rreth | | 10 min |

E martë: Ndezja

- | | | |
|---|-------------|--------|
| • Hapja në rreth | | 10 min |
| • Qendra Gjuhësore:
R është për raketë | PS-SPACE-05 | 25 min |
| • Qendra Matematikore
Ndërtimi i Raketave | PS-SPACE-06 | 25 min |
| • Tema Qendrore
Gjërat për t'i marrë në hapësirë | PS-SPACE-07 | 25 min |
| • Qendra e Artit
10, 9, 8, 7... | PS-SPACE-08 | 25 min |
| • Mbyllja në rreth | | 10 min |

E mërkurë: Hapësira e Jashtme

- | | | |
|---|-------------|--------|
| • Hapja në rreth | | 10 min |
| • Qendra Gjuhësore:
Ushtroni pyetjet KSÇ | PS-SPACE-09 | 25 min |



- | | | |
|--|-------------|--------|
| • Qendra Matematikore
Lëvizësja në Hapësirë | PS-SPACE-10 | 25 min |
| • Tema Qendrore:
Filmat për Rutinën Ditore | PS-SPACE-11 | 25 min |
| • Qendra e Artit
Filmat për Rutinën Ditore, vazhdim | PS-SPACE-11 | 25 min |
| • Mbyllja në rreth | | 10 min |

E enjte: Ecja në Hënë

- | | | |
|---|-------------|--------|
| • Hapja në rreth | | 10 min |
| • Qendra Gjuhësore:
Tregimi për Neil Armstrongun | PS-SPACE-12 | 25 min |
| • Qendra Matematikore
Gjeni rrugën tuaj përreth | PS-SPACE-13 | 25 min |
| • Tema Qendrore
Gjurmë në hënë | PS-SPACE-14 | 25 min |
| • Qendra e Artit
Krijoni hënë | PS-SPACE-15 | 25 min |
| • Mbyllja në rreth | | 10 min |

E premte: Kthehuni në Tokë/Dita e Ekskursionit

- | | | |
|----------------------------------|--|--------|
| • Hapja në rreth | | 10 min |
| • Ekskursionit
Kthimi në Tokë | | TBA |
| • Mbyllja në rreth | | 10 min |

Ndezja PS

Titulli:	H është për Hapësirë!	Kodi:	PS-SPACE-01
Subjekti:	Shkenca - Qendra Gjuhësore	Koha:	25 min
Qëllimi i Aktivitetit:	Që fëmijët të praktikojnë shkronjën H		
Përshkrimi /si të luajë:	<p>A&L na mirëpresin në qendrën e përgatitjes. Këtu astronautët dhe ne ushtrojmë për misionet në hapësirë. Hapësira ka shumë sfida dhe sot ne do të përgatitemi. Por përgatitja e parë është drejtshkrimi!</p> <p>Çfarë është shkronja e parë në fjalën Hapësirë? 'H'. Le të shkruajmë shkronjën së bashku, individualisht dhe gjithashtu ta themi shkronjën. Çfarë fjalë të tjera fillojnë me shkronjën 'H'?</p> <p>Jepini çdo fëmije një copë letre të zezë dhe një shkumës. Thuaniatyre që të bëjnë yje me H-jat në mes të hapësirës!</p>		
Variacione:	Përsëriteni aktivitetin për të gjitha shkronjat në fjalën Hapësirë.		
Pikat e Diskutimit:	Përfshihet më lart.		
Fjalori:	Hapësirë, yje		
Materiale:	Letër të Zezë, shkumës		
Fletë pune:	Asnjë		
Referencat:	Asnjë		

Ndezja PS

Titulli:	Le të përgatitemi	Kodi:	PS-SPACE-02
Subjekti:	Shkenca - Qendra Matematikore	Koha:	25 min
Qëllimi i Aktivitetit:	Që fëmijët t'i praktikojnë numrat duke bërë zgjatje		
Përshkrimi /si të luajë:	<p>Si pjesë e trajnimit, A&L na shpjegojnë se ne duhet të jemi të fortë fizikisht. Por trajnimi është i vështirë.</p> <p>Pjesë e trajnimit është zgjatja. A bëni zgjatje ju çdo ditë? Astronautët duhen të bëjnë. Ne do të bëjmë një seri të zgjatjeve (jashtë në qoftë se është bukur). Duhet ta mbajmë çdo zgjatje për 15 sekonda. A mund të numëroni deri në 15? Le të ushtrojmë para se të fillojmë!</p> <p>Tani, tutori/udhëheqësi do të fillojë zgjatjet. Le të udhëheqin fëmijët një zgjatje në qoftë se ata duan. Bëni një seri të zgjatjeve.</p> <p>Pastaj, astronautët duhen të ushtrojnë. Ata duhen të vrapojnë, të kërcëjnë, të hidhen, të notojnë etj për 20 sekonda. A mund të numëroni deri në 20? Le të ushtrojmë. Tani le t'i bëjmë aktivitetet për 20 sekonda.</p>		
Variacione:	<p>Ndryshoni aktivitetet e vrapimit dhe zgjatjet.</p> <p>Nëse fëmijët nuk mund të numërojnë deri në 20, numëroni deri në 10 dy herë.</p>		
Pikat e Diskutimit:	A doni të ushtroni çdo ditë?		
Fjalori:	Ushtrim		
Materiale:	Asnjë		
Fletë pune:	Asnjë		
Referencat:	Asnjë		



Ndezja PS

Titulli:	Dizejtoni një kostumi astronauti	Kodi:	PS-SPACE-03
Subjekti:	Shkenca - Tema Qendrore	Koha:	25 min
Qëllimi i Aktivitetit:	Që fëmijët të dizejnojë një kostum astronauti		
Përshkrimi /si të luajë:	<p>Hapi i ardhshëm në përgatitjen për hapësirë është që të kemi një kostum astronauti për ta veshur në hapësirë. Le të shikojmë pjesët e një kostumi astronauti - na duhet:</p> <p>Helmetë, veshje e fortë për pjesën e lartë të trupit dhe për këmbët, makina shpëtimi, dy pako të oksigjenit, doreza, këpucë, dëgjuese për komunikim, dhe shumë pjesë të tjera.</p> <p>Diskutoni se për çfarë ne kemi nevojë për këto pjesë.</p> <p>Tani ngjyrosni kostumin tuaj të astronautit. Çfarë ngjyra do të përdorni?</p>		
Variacione:	Asnjë		
Pikat e Diskutimit:	A doni të vishni një kostum të hapësirës? A mendoni se është e rëndë?		
Fjalori:	Kostum astronauti		
Materiale:	Markera		
Fletë pune:	Kostum astronauti (PHO-SPACE-01)		
Referencat:	http://starchild.gsfc.nasa.gov/docs/StarChild/space_level2/spacesuit.html http://coloringpagesplus.com/space/space-space4.gif		



Ndezja PS

Titulli:	Garat	Kodi:	PS-SPACE-04
Subjekti:	Shkenca - Qendra e Artit	Koha:	25 min
Qëllimi i Aktivitetit:	Që fëmijët të vrapojnë		
Përshkrimi /si të luajë:	<p>A&L na kujtojnë se punimi në hapësirë nuk është e lehtë. Në stacionin e anijes kozmike ose në hapësirë, ndonjëherë gjërat prishen dhe ne duhet t'i rregullojmë ato. Por sepse nuk ka shumë oksigjen jashtë në hapësirë, ne na duhet të presim radhën tonë.</p> <p>Formoni dy rreshta me fëmijët. Brenda anijes kozmike ku ne qëndrojmë në këmbë është e një model i asaj që kemi detyrë ta ndërtojmë në hapësirë me blloqe ndërtimi. Vizatoni dy vija në terren, një ku mbaron anija kozmike dhe tjetra ku duhet të ndërtojmë në hapësirë.</p> <p>Njëri pas tjetrit, fëmijët mund të vrapojë në hapësirë, të vej poshtë një bllok dhe të vrapojë përsëri që të prek fëmijën tjetër në radhë për të shkuar.</p> <p>Vazhdoni derisa modeli është ndërtuar. Nëse lejon koha, përsëritni me një gjë më vështirë për të ndërtuar.</p>		
Variacione:	Përqendrohuni në ngjyra duke ju thënë atyre të ndërtojnë atë me të njëjtën ngjyrë në të njëjtën renditje.		
Pikat e Diskutimit:	A është e lehtë apo shpejtë që secili prej jush të vendosni poshtë një bllok?		
Fjalori:	Anije kozmike		
Materiale:	Blloqe ndërtimit		
Fletë pune:	Asnjë		
Referencat:	Asnjë		

Ndezja PS

Titulli:	R është për raketë	Kodi:	PS-SPACE-05
Subjekti:	Shkenca - Qendra Gjuhësore	Koha:	25 min
Qëllimi i Aktivitetit:	Që fëmijët të ushtrojnë shkronjën 'R'		
Përshkrimi /si të luajë:	<p>Tani që ne jemi të gatshëm për hapësirë, A&L na marrin që të vizitojmë vendin ku ne do të ndizemi . Por çfarë na duhet për të ndezur? Një raketë!</p> <p>Me cilën shkronjë fillon fjala raketë? 'R'. Mund të thuani dhe të shkruani shkronjën "R". Të dy "R" dhe "r".</p> <p>Hidhni një sy fotos së raketës. Diçka po mungon ... tymi. A mund të ngjyrosni raketën dhe të bëni shtigje të tymit në forma 'R' pas raketës.</p>		
Variacione:	Shkruani fjalën Raketë në raketë në qoftë se fëmijët kanë mundësi		
